Seancës Plenare

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

KUVENDI
NR 1045 DATE 20.03.24

Nr.______ prot

Tiranë, më __/__ 2024

Lënda: Amendament për projektligjin "Për sigurinë kibernetike"

KRYETARES SË KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Sh.S. Znj. Lindita Nikolla

Mbështetur në nenin 75, pika 4, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, propozoj që në projektligjin "Për sigurinë kibernetike" të bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

- **Në nenin 3, të projektligjit shtohet paragrafi i dytë më përmbajtje si vijon:**

Neni 3

2. Ky ligj nuk zbatohet për autoritetet e administratës publike që kryejnë veprimtaritë e tyre në fushat e sigurisë kombëtare, sigurisë publike, mbrojtjes ose zbatimit të ligjit, duke përfshirë parandalimin, hetimin, zbulimin dhe ndjekjen e veprave penale.

- **Në aneksin 1 " Sektorë me kritikalitet të lartë" të hiqet:**

Sektori "Subjektet që ofrojnë shërbime ose hostojnë sisteme për përpunimin dhe transmetimin e informacionit të klasifikuar, që lidhen më sigurinë publike".

- **Në aneksin 1 " Sektorë me kritikalitet të lartë" të ndryshohet:**

Në Sektorin Administrata Publike pas fjalëve "Institucionet e pavarura" shtohen fjalët "përjashtimisht ato të përcaktuara në pikën 2 të nenit 3".

DEPUTETI PROPOZUES

Jorida TABAKU

RELACION

Siguria kibernetike, konsideruar nevojën e patjetërsueshme për teknologjinë e informacionit, është e domosdoshme. Kjo domosdoshmëri është theksuar edhe me rastet e fundit të sulmeve kibernetike që kanë ndodhur në vendin tonë në vazhdueshmëri ndaj institucioneve qeveritare, institucioneve financiare dhe subjekte të tjera private apo publike.

Sipas një studimi[1], "*sulmet kibernetike në infrastrukturën kritike mund të shkaktojnë efekte dytësore dhe terciare zinxhir që, në disa raste, shkaktojnë më shumë dëme kolaterale sesa vetë sulmi.*
Impakti dhe efektet zinxhir të sulmeve kibernetike janë të dëshmuara nga sulmi kibernetik ndaj Shqipërisë, në mars 2021, që synoi paralizimin e shërbimeve publike dhe fshirjen e plotë të informacioneve nga databaza shtetërore; solli si pasojë publikimin e të dhënave personale të punëtorëve dhe zyrtarëve shtetërorë.
Në vitin 2022, rreth 1 milion sulme kibernetike shënjestruan Shqipërinë, ku 80% e tyre e kishin origjinën nga Irani".

Po sipas këtij studimi "*Nga një vlerësim i riskut për rastin e mësipërm mund të thuhet se:*

- *Shqipëria mund të konsiderohet "hotspot" i krimeve kibernetike me natyrë terroriste:*

Shqipëria aktualisht është subjekt i sulmeve kibernetike me natyrë terroriste por mund të rrezikoj të jetë një territor i cili mund të përdoret nga organizata të ndryshme për të kryer veprime terroriste kibernetike ndaj shteteve të tjera.

- *Rritja e sulmeve të ngjashme: Ky sulm mund të shërbejë si shembull për grupet e tjera terroriste të cilat mund të dëshirojnë të ndjekin shembullin dhe të kryejnë sulme të ngjashme në të ardhmen. Kjo* *rrit mundësinë e përhapjes së sulmeve të këtij lloji dhe përdorimin e taktikave të ngjashme të dëmshme në Shqipëri.*

- *Rritja e tensioneve ndërkombëtare: Sulmet kibernetike të tilla kanë çuar në prishjen e marrëdhënieve ndërkombëtare midis vendeve dhe të çojnë në tensione të mëtejshme diplomatike dhe politike edhe me shtete të tjera jo miqësore me Shqipërinë siç është dhe rasti i Rusisë.*
- *Rënia e besimit publik në sigurinë kibernetike: Sulmet kibernetike të tilla mund të shkaktojnë një rënie të besimit publik në sigurinë kibernetike dhe në aftësinë e qeverisë për të mbrojtur infrastrukturën kritike nga këto rrezique.*

Në vijim të depozitimit në Kuvendin e Republikës Shqipërisë nga Këshilli i Ministrave për shqyrtim projektligjin "Për sigurinë Kibernetike" dhe shqyrtimit të tij në Komisionin për Çështjet Europiane, konfirmohet se përafrimi i tij është i pjesëshëm, pra jo të gjitha nenet e tij janë përafruar me direktivën e Bashkimit Europian[2].

Duke krahasuar dispozitat e direktivës me ato të projektligjit, rezulton se direktiva, përsa i përket fushës së zbatimit, ka raste përjashtimore.

Neni 2 pika 7 e direktivës sanksionon:

Sipas studimit "Siguria kibernetike dhe përgjigjet shumëaktoriale ndaj kërcënimeve dhe terrorizmit kibernetik, produkt i programit "Siguria kibernetike një kërcënim modern për demokracinë", zbatuar nga Instituti për Aktivizëm dhe Ndryshim Social, mbështetur nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përmes Programit të Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci.

[2] Direktiva (BE) Nr.2022/2555 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, datë 14 dhjetor 2022 "Mbi Masat për një nivel të lartë të përbashkët të sigurisë kibernetike në të gjithë Bashkimin Evropian"

7. Kjo direktivë nuk zbatohet për autoritetet e administratës publike që kryejnë veprimtaritë e tyre në fushat e sigurisë kombëtare, sigurisë publike, mbrojtjes ose zbatimit të ligjit, duke përfshirë parandalimin, hetimin, zbulimin dhe ndjekjen e veprave penale.

Neni 3 i **projektligjit** sanksionon se "*Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të gjitha ato subjekte publike dhe private që administrojnë sisteme dhe rrjete të informacionit, sipas përcaktimeve të bëra në anekset I dhe II të këtij ligji.*

Ndërkohë që projektligji në fushën e zbatimit të tij nuk parashikon këto raste përjashtimore sipas direktivës.

Edhe Ligji nr.2/2017 "Për sigurinë kibernetike", aktualisht në fuqi sanksionon disa raste përjashtimore, sikurse:

Në nenin 2 parashikohen përjashtimet nga normativa e përgjithshme si vijon:

[...]

Përjashtohen nga zbatimi i këtij ligji rrjetet e komunikimeve elektronike dhe sistemet e informacionit që janë objekt i rregullimeve ligjore në fuqi për nënshkrimin elektronik, identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara, rrjetet e komunikimeve elektronike dhe sistemet e ***informacionit që përpunojnë, arkivojnë ose transmetojnë informacion të klasifikuar shtetëror, të cilat rregullohen me ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, "Për informacionin e klasifikuar "Sekret shtetëror""****, si dhe rrjetet e komunikimeve elektronike e sistemet e informacionit, për aq sa parashikohet në legjislacionin mbi komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë.*

Nga krahasimi i këtyre tre dispozitave, si dhe referuar nenit 7 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, i cili garanton parimin *check and balance* dhe pavarësinë e institucioneve, kritere thelbësore për shtetin e së drejtës, rezulton se neni 3 i projektligjit cënon këtë nen të kushtetutës si dhe nuk është konformë me direktivën e BE Nr.2022/2555.

Për këtë arsye propozohet amendamenti:

Në nenin 3, të projektligjit shtohet paragrafi i dytë më përmbajtje si vijon:

Neni 3

2. Ky ligj nuk zbatohet për autoritetet e administratës publike që kryejnë veprimtaritë e tyre në fushat e sigurisë kombëtare, sigurisë publike, mbrojtjes ose zbatimit të ligjit, duke përfshirë parandalimin, hetimin, zbulimin dhe ndjekjen e veprave penale.

Gjithashtu me ndryshimin e këtij neni, duhen reflektuar dhe në anekset e projektligjit:

- **Në aneksin 1 " Sektorë me kritikalitet të lartë" të hiqet:**

Sektori "Subjektet që ofrojnë shërbime ose hostojnë sisteme për përpunimin dhe transmetimin e informacionit të klasifikuar, që lidhen më sigurinë publike".

- **Në aneksin 1 " Sektorë me kritikalitet të lartë" të ndryshohet:**

Në Sektorin Administrata Publike pas fjalëve "Institucionet e pavarura" shtohen fjalët "përjashtimisht ato të përcaktuara në pikën 2 të nenit 3".